Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe
Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, 28.10.2020 në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Miljana Nikoliq, kryetare, Albert Kinolli, zëvendësi i parë i kryetarit, Fetah Rudi, zëvendësi i dytë i kryetarit Ivan Todosjiviq, Zoran Mojsiloviq, Igor Simiq, Milosh Peroviq, Ljubinko Karadzhiq, Fidan Jilta, Elmi Reçica, Rasim Selmanaj dhe Rasim Demiri, anëtarë.

Munguan: Arbër Rexhaj, Hajrullah Qeko dhe Etem Arifi.

Pjesëmarrësit e tjerë: Përfaqësuesi i Këshillit Konsultativ për Komunitete Zijush Ahmeti, përfaqësuesit e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Nenad Tasiq i Nenad Stojqetoviq, TV RTK 2 dhe Koha

Personeli për përkrahje të komisionit: Koordinator, Natasa Prica-Tishma, zyrtare e fushës, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Miljana Nikoliq,** kryetare e komisionit.

Rendi i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Raportimi i Ministrit për Komunitete dhe Kthim, Dalibor Jevtiq, tema: „ Raporti për punën e ministrisë për vitin 2020”**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua dhe hapi pikën e dytë të rendit të ditës.

2. **Raportimi i Ministrit për Komunitete dhe Kthim, Dalibor Jevtiq, tema: „ Raporti për punën e ministrisë për vitin 2020"**

Ministri i Komuniteteve dhe Kthim, Dalibor Jevtiq, mori pjesë në takimin e sotëm të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të Kuvendit të Kosovës, ku prezantoi raportin për punën e Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit për vitin 2020 dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Gjatë takimit u diskutua për çështje që kanë të bëjnë kryesisht me komunitetet jo-shumicë, të kthyerit dhe personat e zhvendosur, si: mbështetja ekonomike për komunitetet jo-shumicë, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimi dhe institucione të tjera publike, mbyllja e qendrave kolektive, prona e uzurpuar të drejtat e të kthyerve dhe personave të zhvendosur, integrimi i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve dhe mbështetja për arsimim dhe ndihmën për të rrezikuarit gjatë pandemisë Covid-19.

Kryetarja, Miljana Nikoliq, ka përshëndetur pjesëmarrjen e ministrit dhe të këshilltarëve të tij për raportim lidhur me Raportin Vjetor të Punës së kësaj Ministrie. Ajo theksoi se në përputhje me kompetencat, Komisioni shqyrton të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe në këtë rast, raportimi i ministrit lidhur me punën e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 2020. Me qëllim që të merren informatat dhe të dhënat zyrtare.

Konsiderojmë se kjo Ministri është një nga ministritë e rëndësishme kur bëhet fjalë për kthim dhe çështjeve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të komuniteteve. Gjithashtu, ky Komision ka për detyrë kontrollimin e punës së kësaj ministrisë. Ne nuk dëshirojmë që ta kemi vetëm rolin kontrollues, por edhe rolin e bartësit të bashkëpunimit dhe të gjitha marrëveshjet që i arrijmë t'i realizojmë.

Ministri, Dalibor Jevtiq, në fjalimin e tij ai falënderoi për ftesën e komisionit dhe prezantoi aktivitetet kryesore gjatë këtij viti.

Ky vit ishte specifik sepse u përballëm me pandeminë COVID 19, e cila ndikoi në punën e ministrisë dhe planet që kishim. Ne ishim në një bllokadë financiare për gati 6 muaj dhe nuk punuam në projekte që ishin planifikuar për t'u zbatuar.

Qeveria dhe ministria nuk kishin në dispozicion mjete buxhetore. Përkundër faktit se ka të bëjë me zbatimin e strategjive qeveritare për komunitetet, ministria po vepron në mandatin e saj, gjë që mund të shihet nga aktivitetet tona për këtë vit.

Është fakt se ministria zbatoi me kohë të gjitha vendimet e Qeverisë, që ishin marrë me qëllim të shpenzimit të fondeve buxhetore gjatë pandemisë, aplikimit të masave të reja shtrënguese, mbrojtjes gjatë pandemisë dhe të tjera.

Qëllimet strategjike të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK):

1. Kthimi i të zhvendosurve në Kosovë dhe ri-integrimi i tyre,
2. Stabilizimi i komuniteteve,
3. Mbyllja e qendrave kolektive në Kosovë,
4. Mbrojtja institucionale e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, duke zbatuar legjislacionin ekzistuar dhe hartimin legjislacionin e ri.

MKK, si përgjigje në sfidën e krizës së pandemisë, ajo hartoi një program për të mbrojtur dhe ndihmuar të rrezikuarit në Kosovë. Një pjesë e këtij programi është aksioni nën sloganin "Të fitojë jeta” , me ç ‘rast janë ndihmuar 606 familje me pako ushqimore dhe higjienike.

Janë shpërndarë 872 pako ushqimore dhe higjienike (nga MKK dhe partnerët e MKK), me ç’rast kanë përfituar rreth 3.500 persona, 58% pako për Serbë, 15% për Egjiptianë, 12,5% për Romë, 5,6% për Boshnjakë, 4,5% për Shqiptarë, 3,6% për Ashkalinjë , 0,7 për Goranë.

Para fillimit të aksionit (318 pako) MKK ka përcaktuar kriteret dhe janë përzgjedhur komunat dhe përfituesit.

Kriteret për përzgjedhjen e komunave

Kriza e shkaktuar me pandeminë ka rrezikuar edhe më shumë grupet e cenuara të qytetarëve: të kthyerit në mjediset e izoluara, personat e zhvendosur të vendosu nëpër qendra kolektive, kategoritë me asistencë sociale, prindërit vetushqyes, personat e moshuar, personat me invaliditet, pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë etj.

Kriteret për përzgjedhjen e komunave janë: izolimi i komuniteteve të caktuar, jeta në qendrat kolektive, komunat ku jetojnë të kthyerit, komunat që kanë parashtruar kërkesë për ndihmë, mosha e popullatës, paqëndrueshmëria sociale e komuniteteve në komunë, komunat në anën veriore të lumit Ibër, në të cilat ka ndodhur ri integrimi i personave të zhvendosur dhe komunat që janë më të rrezikuara nga pandemija.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të aksionit, komunat kanë dërguar lista të përfituesve, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante në nivelin lokal etj.

Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve- përfituesit e drejtpërdrejtë

Kriza e shkaktuar me pandeminë ka rrezikuar edhe më shumë grupet e cenuara të qytetarëve: të kthyerit në mjediset e izoluara, personat e zhvendosur të vendosu nëpër qendra kolektive, kategoritë me asistencë sociale, prindërit vetushqyes, personat e moshuar, personat me invaliditet, pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë etj.

MKK ka prezantuar kriteret në komuna dhe/ose organeve relevante komunale. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) ka kërkuar lista të përfituesve potencial të ndihmave me produkte ushqimore dhe mjete higjienike. Në valën e parë të pandemisë disa ZKKK kanë kërkuar ndihmë.

Domosdoshmëria e koordinimit – përfituesit indirekt

Kabineti kryetarit të komunës, Kuvendi Komunal, Shtabi i Krizave, Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete, Shërbimi Social, përfaqësuesit e fshatit dhe Këshilli i Fshatit, Këshilli Rinor dhe vendimmarrësit të tjerë në nivelin lokal.

Kthimi i të zhvendosurve në Kosovë dhe ri integrimi i tyre

Sa i përket kthimit të zhvendosurve dhe ri integrimit të tyre në Kosovë, MKK ka ndërmarr të gjitha hapat e nevojshëm, që kanë për qëllim krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm, mbrojtjen, integrimin dhe zhvillimin e komuniteteve. Është me rëndësi të theksohet fakti se MKK ka ofruar kontributin se saj për hartimin dhe zbatimin e Programit të Qeverisë 2020-2023.

MKK realizon fazën e pestë të programit që e financon Zyra e BE, në bashkëfinancim të MKK, ndërsa e zbaton Organizata ndërkombëtare për migracion në 11 komuna të Kosovës.
Me sukses ka filluar ndërtimin e 91 shtëpive për të kthyerit dhe personat e zhvendosur, nga kjo 86,8% për Serbë, dhe 13,2% për të tjerët (4,4% për Romë, 4,4% për Ashkalinj, 3,3% për Egjiptianë, 1% për Boshnjakë).
Me sukses ka përfunduar ndërtimi dhe është kryer pranimi teknik për 53 shtëpi të reja, ndërsa deri në fund të vitit 2020 është planifikuar, në bazë të këtij projekti, të ndërtohen edhe 101 shtëpi për të kthyerit dhe të zhvendosurit.
Misioni kryesor i MKK është kthimi, i cili nuk është në nivel të duhur, veçanërisht për shkak të konteksteve pronësore juridike (uzurpimi i pronës), sfidave të sigurisë, fillimin e procedurave gjyqësore dhe të gjitha këto çështje janë të lidhur në mes veti, prandaj kjo çështje i përket të gjitha institucioneve dhe jo vetëm Ministrisë për Komunitete dhe Kthim . Faktor vendimtar në këtë drejtim nuk duhet të jetë vullneti politik por sundimi i të drejtës. Është evidentuar një numër i madh i sulmeve ndaj të kthyerve dhe pronës se tyre.
Institucionet politike, qeverisja lokale, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar KFOR-in dhe misioni i tyre është heqja e barrierave për të gjithë ata që dëshirojnë të kthehen. Personalisht nuk jam i kënaqur me çështjen e kthimit, sepse janë kthyer vetëm 200 familje, por ka edhe të tjerë që dëshirojnë të kthehen. Kthimi nëpër komuna ndryshon. Janë evidente vështirësitë me të vilat do të përballemi.
Në këtë drejtim është i nevojshëm angazhimi i gjithë shoqërisë dhe jo vetëm i Ministrisë.
Unë angazhohem për vendosjen e të gjitha formave të bashkëpunimit dhe koordinimit, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të përbashkëta, që do të rezultonte me punën e suksesshme.
Fakti se peticioni i Romëve në territorin e Komunës së Obiliqit ka bllokuar kthimin. Këtë drejtë nuk e ka askush, ndërsa pushteti lokal duhet të përfshihet dhe t'i zgjidhin problemet, në pajtim me masa mbrojtëse që tashmë i ka ndërmarr ministria.
Veçanërisht më gëzon kthimi i atyre që janë kthyer me ndihmën e UNHCR-it në Kosovë nga Maqedonia dhe Mali i ZI, të cilët kanë gjete vendstrehim të përkohshëm, para së gjithash familjet Rome (25), Ashkali (17), Egjiptian (8) dhe Goranë (1) në territorin e komunave Prizren, Ferizaj, Obiliq, Graçanicë, Dragash, Pejë dhe Gjilan.

Ministri, gjithashtu ka deklaruar se nuk do të ishte e mundshme të arrihen këto rezultate pa përkrahjen pa rezerve të partnerëve ndërkombëtar, para së gjithash Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Mbyllja e qendrave kolektive

Me qëllim të mbylljes së 5 qendrave kolektive në Komunën Shtërpce, ka përfunduar ndërtimi 5 ndërtesave për 91 familje të zhvendosur, me gjithsej 177 anëtarë, të cilët janë banorë të qendrave kolektive. Pritet vendosja e këtyre 91 familje deri në fund të vitit. Banesat e mbetura do t'i ndahen të zhvendosurve dhe familjeve me asistencë sociale.

Ne Qendrën kolektive „BERGEN" fshati Uglarë – Graçanicë, në vazhdim është rinovimi i6 ndërtesave, ku jetojnë 21 familje të zhvendosura. MKK, gjithashtu paguan qira për këto familje, që presin vendosjen në këto banesa të rinovuar.

Është duke u punuar në mënyrë intensive në drejtim të përgatitjes së dokumentacionit për ndërtimin e ndërtesave të reja në Komunën Leposaviq, ku jetojnë 64 persona të zhvendosur intern në 2 qendra kolektive, dhe në Komunën e Zveçanit ku jetojnë 38 persona në 2 qendra kolektive, në kushte që nuk janë të dinjitetshëm për njeriun.
Krahas pandemisë, Ministria edhe më tutje do të punojë me qëllim të zgjidhjes së problemeve të të gjithë qytetarëve, në bashkëpunim dhe koordinim me qeverisjen lokale dhe organizatat ndërkombëtare.

Stabilizimi dhe fuqizimi ekonomik i komuniteteve

Paralelisht me ndërtimin e shtëpive janë dorëzuar 65 pako familjare për personat e kthyer dhe të zhvendosur. Nga kjo 81,7% pako për Serbë, 6,1% për Romë, 6.1% për Ashkali, 4,6% për Egjiptian, 1,5% për Boshnjakë. Ky numër do të jetë edhe më i madh deri në fund të vitit.
Janë dorëzuar 100 mjete individuale nxitëse (grande) për realizimin e të ardhurave dhe hapje të bizneseve. Nga 100 grande 35% janë për Serbë, ndërsa 65% për të tjerët – 19% projekte për Ashkalinjë, 15% për Egjiptian, 9% për Boshnjakë, 6% për Shqiptarë, 6% për Turq, 5% për Romë dhe 5% për Goranë.
Këtë program të fuqizimit ekonomik, MKK e realizon me përkrahjen e Zyrës së BE në Kosovë.
Njëkohësisht me këto zgjidhje të përkohshme, MKK me partnerë dhe qeverisje lokale punojnë në mënyrë intensive për sigurimin e zgjidhjeve të përhershme për këta të rrezikuarit. Në përgjithësi, ne dëshirojmë që t'i përgjigjemi të gjitha komuniteteve, në mënyrë të barabartë, por është i nevojshëm angazhimi më i madh i të gjitha institucioneve. Ne bëjmë përpjekje që t'i prezantojmë të gjitha problemet dhe pengesat.

Hartimi i legjislacionit të ri me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të komuniteteve

Deri më tash është vërejtur se nuk ekzistojnë mekanizma të mjaftueshme juridike për realizimin e të drejtave të garantuar të pjesëtareve të komuniteteve dhe personave të zhvendosur. Gjithçka ka të bëjë me vullnetin politik. Është me rëndësi që kjo çështje të rregullohet me ligj.

Një pikë e Marrëveshjes së Uashingtonit lidhur me legjislacionin është iniciuar në Bruksel:

- ✓ Koncept dokumenti për përkrahjen e komuniteteve, me të cilat janë definuar kriteret lidhur me ndihmën që MKK u ofron pjesëtarëve të komuniteteve, dhe
- ✓ Koncept dokumenti për të zhvendosurit, që merret me çështjet që kanë të bëjnë me personat e zhvendosur intern dhe refugjatët në Rajon, dhe modelet për përmirësimin e pozitës së tyre dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pritet që të dy dokumentet deri në fund të vitit do t'i dorëzohen Qeverisë për miratim.

- ✓ Ministri Jevtiq ka theksuar nevojën e hartimit të Ligjit për Kthimin e të Zhvendosurve – pritet që së shpejti do të fillojë hartimi i këtij Ligji, me të cilin do të zgjidheshin çështjet kontestuese lidhur me krimin e qëndrueshëm, integrimit, stabilizimit dhe zhvillimit të gjitha komuniteteve, duke kërkuar përkrahjen e të gjitha institucioneve relevante dhe partnerëve, duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës.

Sa i përket raportit për punën e MKK, ata hartohen çdo 6 muaj dhe në baza vjetore, ku prezantohen të gjitha aktivitetet e ministrisë. Theksoj që deri më tash nga ne nuk janë kërkuar raportet me shkrim, por megjithatë ne do t'i përgjigjemi edhe këtyre kërkesave. Sa i përket strukturës të të punësuarve, respektimi i parimit të përfaqësimit të të punësuarve, 35% i të punësuarve vijnë nga . komunitetet pakicë, që do të thotë se ministria i përmbushë obligimet ligjore. Gjithashtu, kjo ka të bëjë në strukturën e Këshillave drejtuese të ndërmarrjeve publike.

Sa i përket buxhetit të ministrisë, ministri ka theksuar se ekziston nevoja për buxhet më të madh dhe në vitin 2020 është shpenzuar 98,8% të buxhetit, pa suficit. Në pajtim me fondet IPA si fonde të para-anëtarësimit të BE, marrim pjesë përmes organizatave të caktuara për realizimin e projekteve. Është e vërtetë se në këtë është zvogëluar buxheti i ministrisë për 50%, por ne kemi ofruar ndihmë edhe gjatë kohës së pandemisë dhe do të vazhdojmë të ndihmojmë, ndërsa është i rëndësishëm bashkëpunimi dhe koordinimi i qeverisjeve lokale.

Çështja e shkollës në fshatin Drajqiq, duhet të zgjidhet nga se fëmijët duhet të kenë shkollë. Ne jemi të gatshëm të punojmë në këtë drejtim dhe njëkohësisht ta mbrojmë objektin e vjetër si objekt kulturor dhe historik.

Përmes qasjes së saj të vazhdueshme institucionale dhe shërbimeve efikase, MKK-ja, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, vazhdoi të zbatojë aktivitete që synojnë ndërtimin e besimit të ndërsjellë, duke siguruar mundësi të barabarta për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, përfshirë komunitetin shqiptar që jeton në Veri të Kosovës. Fjala "ndërtim i besimit të ndërsjellë" duhet të ndërtohet përmes bashkëpunimit dhe sundimit të ligjit, dhe kjo është përparësia e punës së ministrisë. Kemi ndryshime pozitive në atë drejtim, gjë që dëshmon bashkëpunimi konstruktiv i Ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, gjatë pandemisë, që u vlerësua pozitivisht nga publiku vendorë dhe faktorët ndërkombëtarë. Bashkëpunimi ynë ka kontribuar në ndërtimin e besimit shumë të nevojshëm dhe veprimit të përbashkët kundër përhapjes së virusit në kohën e pandemisë.
Falë një koordinimi të mirë dhe efikas me Ministrinë e Shëndetësisë, Doganave dhe Policisë së Kosovës, është mundësuar që dërgohen dhe të kthehen nga Serbia pacientët më gjendje më të vështirë shëndetësore, të cilët kanë sigurim shëndetësor në Serbi dhe të trajtohen atje falas.

Ky ishte një hap konkret përpara në ndërtimin e besimit midis komunitetit serb dhe institucioneve të Kosovës.

Pyetjet dhe sugjerimet

- Gjatë takimit u diskutua për çështjet që preokupojnë kryesisht komunitetet jo-shumicë, të kthyerit dhe personat e zhvendosur, siç janë: mbështetja ekonomike për komunitetet jo-shumicë, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimi dhe institucione të tjera publike, mbyllja e qendrave kolektive, prona e uzurpuar dhe të drejtat pronësore të të kthyerve dhe personave të zhvendosur, integrimi i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve dhe mbështetja për arsimim dhe ndihmën për të prekurit gjatë pandemisë Covid-19.

- Përgjigjet mund të shihen në prezantimin e ministrit.

Kryetarja, Miljana Nikoliq, tha se ka dëgjuar me kujdes prezantimin e Ministrit dhe problemet e që përcjellin punën e ministrisë. Situata me të cilën po përballemi me pandeminë COVID-19 ka ndikuar në punën dhe planin e punës së ministrisë. Duke qenë se COVID-19 është një sëmundje e frymëmarrjes që nuk mund të parashikohet për sa i përket sa do të zgjas dhe që mund të transmetohet nga një person te tjetri, MKK-ja si institucion nuk u kujdes për punën, dhe ndihmoi njerëzit dhe të gjitha komuniteteve, që konfirmojnë edhe informacionet dhe të dhënat që paraqitët sot në luftën kundër COVID 19. Ne ju falënderojmë për përkushtimin dhe kontributin tuaj në një urgjencë kaq të vështirë globale shëndetësore.

- ***Unë konsideroj se çështja e kthimit, çështja e mbijetesës dhe e ardhmja e komuniteteve, kështu që në këtë kontekst, pyetja ime ka të bëjë me situatën e qendrave kolektive ku jetojnë personat e zhvendosur dhe familjet e me asistencë sociale, dhe***
- ***Korniza kohore për nxjerrjen e Ligjit për Kthim dhe të Zhvendosurit;***

Fetah Rudi, vlerësoi punën e MKK, dhe do të ishte mirë që të gjithëve t'i dorëzohet raporti i punës, i cili përmban të gjitha elementet lidhur me punën dhe aktivitetet e ministrisë dhe komunave.

- ***Vërejtja ime ka të bëjë me ndarjen e ndihmës së barabartë për komunitete në të gjitha komunat, në pajtim me gjendjen faktike, dhe jo vetëm në komunat Leposaviq dhe Brezovicë.***
- **Veton Berisha,** kishte disa sugjerime dhe vlerësime dhe tha se si përfaqësues të komuniteteve tona ne kemi interes të monitorojmë miratimin e ligjeve dhe ndikimin e tyre ose shkeljen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Ndër të tjera, ne kemi mundësinë të shqyrtojmë problemet e të gjitha komuniteteve, pavarësisht nëse është një komunitet i pakicës apo shumicës. Sa i përket kthimit, pas luftës, anëtarët e komunitetit egjiptian nuk u kthyen në shtëpitë e tyre, duke e ditur se nuk kishin shtëpi dhe kushte elementare për jetë në kuptimin shoqëror dhe ekonomik, kështu që kthimi i tyre u bllokua. Në lidhje me këtë, ai kërkoi përgjigje për disa pyetje:

- ***Transparenca dhe numri i raporteve lidhur me aktivitetet e qeverisjeve lokale;***
- ***Faktorët që ndikojnë në kthim më të suksesshëm dhe të dhënat statistikore lidhur me kthimin e komuniteteve;***
- ***A është duke u respektuar dhe në çfarë mase zbatohet neni 11 i Ligjit për Shërbimin Civil nga ana e Ministrisë, përkatësisht respektimi i të punësuarve në vendet e rezervuara (kuota minimale dhe maksimale në përqindje 10% të vendeve të rezervuara), që i takojnë komuniteteve;***

Rasim Demiri, falënderoi Ministrin dhe bashkëpunëtorët e tij për raportimin në komision dhe theksoi se analiza e takimit të sotëm nuk do të ketë rezultate nëse nuk arrijmë rezultate në një fushë tjetër, dhe kjo është arsyeja pse ne jemi këtu dhe pse kjo ministri ekziston. Analiza është e nevojshme, në mënyrë që të tejkalohen lëshimet të caktuara dhe të zgjidhen ato, në mënyrë që të dy komisionet dhe ministria të kenë vërtet më shumë efekt pune. Unë mendoj se kjo ministri është një nga ministritë më të rëndësishme kur bëhet fjalë për komunitetet, kur bëhet fjalë për kthim dhe gjithçka që ka të bëjë me realizimin e interesave të caktuara të komuniteteve. Kjo është arsyeja pse unë mendoj se është shumë e rëndësishme që të forcohet bashkëpunimi midis Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Ministrisë.

Lidhur me këto komunitete që gjenden këtu, veçanërisht komuniteteve të tjera dhe komuniteteve jo shqiptare, parashtrohen këto pyetje:

- ***Në çfarë mënyre është kryer ndarja dhe zbatimi i programit të ndihmës së ministrisë në kohën e COVID-19;***
- ***Sa mjete buxhetore ka shpenzuar Ministria për këtë vit, me sugjerim që Ministria të angazhohet seriozisht për rritjen e buxhetit për vitin e ardhshëm 2021;***
- ***Çka ka ndërmarr Ministria apo dikush tjetër lidhur me ndërtimin e shkollës në fshatin Drajqiq, me popullatë shumicë Boshnjake, sepse fëmijë t fshatit udhëtojnë 15km. Në një fshat tjetër për të vijuar mësimin.***

Albert Kinoli, në emër të komunitetit të tij, falënderoi për të gjitha ato që ministria kishte ndërmarrë në formën e ndihmës gjatë pandemisë. Pozita e komunitetit Rom është shumë e vështirë dhe ndryshimi në raport me komunitetet e tjera është i madh, për sa i përket fuqizimit ekonomik me ndihma individualë dhe stabilizimit të komunitetit. Ai kërkoi që ndihma t'i jepet komunitetit në formën e blerjes së aparateve laptop për shkollimin e fëmijëve në kushtet aktuale. Ai theksoi se gjithçka duhet të bëhet përmes veprimeve të përbashkëta në lidhje me rritjen e buxhetit të ministrisë për 2021. Pyetja ime ka të bëjë me kthimin dhe kjo është,

- ***Nga cila komunë ka ardhur peticioni i Romëve kundër kthimit dhe cilat arsye janë për nënshkrimin e tij;***

Elmi Reçica, theksoi se qëllimi i komisionit dhe institucioneve në përgjithësi është krijimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të mirë, në mënyrë që të realizohet ajo që planifikon ministria, dhe ne si organ legjislativ të biem dakord së bashku. Ai tha se komisioni edhe ministria mund të fillojnë takime, gjë që nuk është aspak problem. Gjithashtu, mund të pranojmë përgjegjësisë për zgjidhjen e problemeve të caktuara. Këto janë çështje të realizueshme dhe qëllimi i komisionit është shumë i saktë. MKK-ja ka një mision të rëndësishëm në sistemin institucional të Kosovës dhe është ministria e të gjithë qytetarëve. Ministria u përball me shumë vështirësitë dhe sfidat gjatë pandemisë, si dhe me vështirësitë buxhetore. Ai kërkoi një shpjegim lidhur me angazhimin e ministrisë dhe organeve të tjera kompetente në lidhje me Shqiptarët që jetojnë në mjedise ku nuk janë shumicë, dhe kërkoi më shumë vëmendje dhe përkushtim në zgjidhjen e problemeve të tyre në qasjen ekonomike dhe institucionale, si ministrisë, ashtu edhe qeverisë në tërësi. Duhet të theksohet se 6% e buxhetit iu dha pikërisht komunitetit shqiptar në veri. Në periudhën e ardhshme, ne mund të koordinojmë marrëdhëniet ndërmjet ministrisë dhe këtij komisioni, me qëllim të shkëmbimit të mendimeve të përbashkëta në mënyrë që të ndihmojmë komuniteteve dhe Kosovës. Pyetja ime ka të bëjë me:

Statusin e Shqiptarëve në pjesën veriore të Kosovës, a ka lëvizje pozitive në këtë drejtim, si dhe zbatimin e Ligjit për Komunitete, që do të kontribuonte promovimit dhe përmirësimit të drejtave të komuniteteve në terren.

Igor Simiq, falënderoi ministrin dhe këshilltarët për përgjigjen ndaj ftesës së komisionit dhe tha se komisioni parlamentar për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimin ka autorizimin jo vetëm për të kontrolluar punën e kësaj ministrie, por gjithashtu duhet të luajë rolin bashkëpunues për të mirën e të gjithëve.

Ajo që unë e konsideroj të rëndësishme, dhe është pozicioni im personal dhe pozicioni i Listës Serbe, është se përgjegjësia për pozitën e qytetarëve nuk është përgjegjësi e vetëm MKK-së, por përgjegjësi e Qeverisë. Është e nevojshme të jepet kontributi maksimal në të gjitha nivelet e qeverisjes, si lokale ashtu edhe qendrore, veçanërisht në komunat ku jetojnë komunitet e caktuara, veçanërisht komunitetet jo-shumicë, për t'i forcuar dhe ruajtur ato përmes diskriminimit pozitiv, sepse ato paraqesin begati për komuna.

Kur flasim për komunën e Mitrovicës Veriore, megjithëse është e populluar kryesisht nga serbët, falë kryetarit Rakiq, ndihma gjatë pandemisë iu dha 50% të anëtarëve të komunitetit serb, dhe 50% komuniteteve të tjera. Pikërisht ky është një shembull i shkëlqyer i humanizmit dhe solidaritetit në një situatë të pandemie që nuk njeh kufij, komb, fe dhe që sulmon të gjithë botën dhe shkakton dëme të pariparueshme për ekonomi dhe drejtpërdrejt për qytetarët. Gjithashtu, përpjekjet tona si komision do të drejtohen për të dhënë një kontribut në çështjen e rritjes së buxhetit të ministrisë për 2021.

Unë kamë dy pyetje lidhur me sigurinë:

- ***Çfarë është bashkëpunimi në mes të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrisë për punë të brendshme, duke marrë parasysh se gjatë këtij viti janë shënuar dhjetëra sulme të motivuara etnikisht, dhe***
- ***Cili është roli i ministrisë, në kuadër të Marrëveshjes së Uashingtonit, në pikat që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe avancimin e procesit të të zhvendosurve.***

Anëtarët e komisionit ishin unanim në vlerësimin pozitiv të punës së Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit dhe Ministrit Jevtiq, duke theksuar faktin se shumë është arritur në rrethana të jashtëzakonshme të shkaktuara nga pandemia e korona virusit dhe zvogëlimi i buxhetit të ministrisë për gati 50% në vitin 2020. Disa deputetë, gjithashtu theksuan se është e papranueshme që 20 vjet pas konfliktit në Kosovë, të kemi qendra kolektive ku jetojnë persona të zhvendosur nga Kosova, dhe se ata personalisht do të mbrojnë idenë e rritjes së buxhetit të kësaj ministrie dhe mbylljen e të gjitha qendrave kolektive në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në 13:10.

Njësia për komisione parlamentar

Kryetarja e komisionit

Miljana Nikoliq